VENDIM
Nr.1615, datë 10.12.2008

PËR KALIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT NGA MINISTRIA E MBROJTJES MINISTRISË SË DREJTËSISË, TË OBJEKTIT "SHTËPIA E USHTARAKËVE, POGRADEC, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, shkronja "c", të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë dhe të Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin e përgjegjësisë së administrimit nga Ministria e Mbrojtjes Ministrisë së Drejtësisë, të objektit "Shtëpia e ushtarakëve, Pogradec", me sipërfaqe 750 (shtatëqind e pesëdhjetë) m^2, me numër rendor 23 (faqe 130), në listën, që i bashkëlidhet vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.
2. Ky objekt të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes", të ndryshuar.
3. Ngarkohen Ministri i Drejtësisë, Ministri i Mbrojtjes dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

1. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË VEÇANTA)

Bashkia/komuna:
Fusha e përdorimit të pronës:

	A			**B**			**C**			
Nr. Rend.	**Zona kadastr.& indeksi i hartës**	**Nr. pasurisë**	**Lloji i pronës**	**Emri i pronës, adresa**	**Sip. totale e pronës (m^2)**	**Nga sip totale: sa ndërtesë (m^2)**	**Funksioni për të cilën përdoret prona**	**Institucioni/enti me përgjegjësi administrative**	**Institucioni/enti përdorues, statusi juridik i përdorimit**	**Të dhëna të tjera (Shënime të veçanta)**
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1		23	Ndërtesë dhe truall	Shtëpia ushtarake Pogradec, lagj. nr.4, Pogradec	750	500	E lirë	Ministria e Mbrojtjes	Qira	Miratuar për kalim administrimi Ministrisë së Mbrojtjes, me VKM nr.515, datë 18.7.2003